



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.649/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Aida Alimi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare të publikuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Aida Alimi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, me shenjë ZL.Anr.649/2017 e datës: 09.11.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017 në ora 13:15, nga Aida Alimi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, me të cilën pretendon se i mungojnë votat familjare në vendvotimet: 0901E/02R, 0903E/03R, 091E/10R, 0901E,13R, 0901X/10D, 0911E/01D dhe 0915E/01D si dhe ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në këto vendvotime.

Parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur Formularët e Përputhjes së të dhënave dhe Rezultateve (FPR).

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesja e ankesës Aida Alimi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Fushë Kosovë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), pretendimet e tij nuk i ka argumentuar me asnjë provë, duke i specifikuar vetëm QV-të me VV-të pa e dhenë asnjë të dhënë se sa vota i mungojnë në vendvotimet: 0901E/02R, 0903E/03R, 091E/10R, 0901E,13R, 0901X/10D, 0911E/01D dhe 0915E/01D, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: *“se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të specifikuara mirë, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i ankesës nuk ka treguar se sa vota i mungojnë, refuzon ankesën si të pabazuar.*

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.649/2017 me datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*